

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6290  
E mërkurë, 14 prill 2021  
çmimi 0.40 €

## Heshtja e autoriteteve të Kosovës për targat jolegale në veri



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

REPUBLIKA E KOSOVËS BËHET GATI PËR KONTINGJENTIN E DYTË TË VAKSINAVE KUNDËR COVID-19

## NË KOSOVË PRITET TË ARRIJNË MBI 100 MIJË DOZA TË VAKSINËS PFIZER/BIONTECH

Kosova deri në fund të qershorit pritet të furnizohet me mbi 100 mijë vakcina Pfizer/BioNTech kundër koronavirusit nga programi COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ndërsa Qeveria e Kosovës ka miratuar të martën nismën për negociimin e marrëveshjes kornizë së kredisë së datës 14 gusht të vitit 2020 ndërmjet Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për financimin e projektit "Reagim emergjent ndaj Covid-19"



### AKTUALE



PASI NUK PËRMENDI UÇK-në, PSD-JA IA VENDOS OSMANIT FLAMURIN NË OBORR TË PRESIDENCËS

ANULOHEK PROJEKTI I TIKA-S PËR RESTAURIMIN E HAMAMIT TË MADH

PRIZRENI, KOMUNA E PARË ME "PIKË VROJTUESE"

### EKONOMI



PËRFUNDOJNË TAKIMET E FMN-së ME BB-në, MERRTE PJESË EDHE BQK-ja

KLUBI I PRODHUESVE FILLON INICIATIVËN E RRJETIT TË ETIKETAVE PRIVATE

### SPORT

LIVERPOOLI BESON NË PËRMBYSJE KUNDËR REALIT



## QEVERIA MIRATON KONCEPTDOKUMENTIN PËR KONFISKIMIN E PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME

## KOMISIONARI I BE-së, LETËR KURTIT: DIALOGU DUHET TË RINISË SHPEJT



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## BE-ja nuk komenton raportimet për letrën e Janshas dhe ndryshimet e kufijve

BRUKSEL, 13 PRILL - Zëdhënësi i Komisionit Evropian dhe i shërbimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë se zyrtarët e bllokut evropian nuk janë në dijeni për ndonjë dokument të dërguar nga kryeministri i Sllovenisë Janez Jansha, për të cilin kanë raportuar mediat në Ballkan, e që supozohet se flet për ndryshimin e kufijve. Mediat, sidomos në Bosnje e Hercegovinë, kanë shkruar se Jansha përmes një letre jozyrtare, që supozohet se i është dërguar presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, ka sugjeruar "përmbylljen e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, duke ndryshuar edhe kufijtë e shteteve". "Ne nuk jemi në dijeni për ndonjë dokument të tillë dhe nuk mund t'i komentojmë spekulimet rreth çështjeve të ngritura në media"

ka thënë ky zëdhënësi i BE-së, duke shtuar se ata janë në dijeni për këto shkrime në media, por nuk kanë çfarë të thonë për këtë temë në mënyrë specifike, pasi ata vetë nuk kanë parë ndonjë dokument të tillë.

Sa i përket idesë për ndryshimin e kufijve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ky zyrtar ka thënë se pozicioni i BE-së është i qartë dhe nuk ka çfarë të ndryshohet. "Mund të themi se sa i përket kufijve, pozicioni i BE-së është i qartë dhe në çështjen e kufijve nuk ka çfarë të ndryshohet. Ne duhet të punojmë drejt bashkëpunimit rajonal, pajtimin dhe drejt zgjidhjes së të gjitha çështjeve të hapura në rajon pa hyrë në fushat e rrezikshme, duke respektuar të drejtën ndërkombëtare dhe parimet e BE-së", ka thënë ky zëdhënësi i Bashkimit



Evropian. Idetë për mundësinë e ndryshimit të kufijve në Ballkan kishin lindur në vitin 2018 kur flitej se presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim

Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, po punojnë për një marrëveshje që mund ta përfshinte edhe shkëmbimin e territoreve. Këto ide patën hasur në

kundërshtime të forta të Gjermanisë dhe disa shteteve të tjera të BE-së, ndonëse disa prej tyre kanë shprehur gatishmëri që të diskutohet edhe për ide të tilla.

## Shkaku i lodhjes me pandeminë, jep dorëheqje ministri i Shëndetësisë në Austri



VJEN, 13 PRILL - Ministri i Shëndetësisë i Austrisë, Rudolf Anschober, ka dhënë dorëheqje nga pozita pasi ndihet i rraskapitur nga lufta me pandeminë e koronavirusit. "Në krizën më të rëndë shëndetësore në dekada, republika ka nevojë për një ministër të Shëndetësisë i cili është 100 për qind i aftë. Ky, aktualisht, nuk jam unë", ka thënë Anschober, duke përmendur problemet me

presionin e gjakut.

"Kam marrë një punë shumë të bukur dhe sfiduese 15 muaj më parë. Më duket sikur nuk kanë kaluar 15 muaj, por 15 vjet", ka thënë ai në një deklaratë për media.

Anschober ka marrë detyrën në janar të vitit 2020, përpara se pandemia ta godiste Austrinë. Anschober, ish-gazetar, 60 vjeç, është një nga politikanët më popullorë të Austrisë, i njohur për shpjegimet e tij të gjata të

sfidave të pandemisë. Ai shpesh ka qenë zë i vetëm në qeveri kur ka kërkuar masa më të rrepta bllokimi përballë numrit të lartë të infeksioneve me koronavirus. Anschober ka thënë të martën se nuk ka pasur asnjë ditë të plotë pushimi për më shumë se një vit, gjë që ka dëmtuar shëndetin e tij.

Austria, vend me 8.8 milionë banorë, ka regjistruar mbi 578 000 raste me koronavirus dhe mbi 9 700 viktima.

## NATO i kërkon Rusisë të mos grumbullojë trupa në kufi me Ukrainën

BRUKSEL, 13 PRILL - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka kërkuar nga Moskë që të mos vazhdojë grumbullimin e trupave të saj në kufi me Ukrainën, ndërsa për këtë të fundit ka shprehur mbështetjen "e palëkundur" të aleancës. Në një konferencë për media me ministrin e Jashtëm të Ukrainës, Dmytro Kuleba, Stoltenberg ka thënë se NATO "i qëndron krah Ukrainës". Sipas tij, veprimet ruse janë "të pajustificueshme, të pashpjegueshme dhe thellësisht shqetësuese".

Komentet vijnë pas shkeljeve në rritje të armëpushimit në lindje të Ukrainës, ku forcat qeveritare ukrainase luftojnë separatistët pro-rusë qysh në vitin 2014. Më 2014 Rusia ka aneksuar në mënyrë të paligjshme edhe Gadishullin ukrainas të Krimesë. "Rusia ka vendosur mijëra trupa luftarake në kufijtë e Ukrainës. Është grumbullimi më i madh i tyre që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë në vitin 2014. Gjatë ditëve të fundit disa ushtarë ukrainas janë vrarë në lindje të Ukrainës", ka deklaruar Stoltenberg.

Kuleba tingëlloi sfidues ndaj Moskës, duke thënë se Ukraina dhe partnerët e saj perëndimorë janë më të përgatitur sesa 7 vjet më parë. "Nëse Moskë ndërmerr ndonjë veprim të pamatur ose fillon dhunë të re, një gjë e tillë do të jetë e kushtueshme në çdo kuptim", ka thënë Kuleba. Të mërkurën në Bruksel do të arrijë edhe sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, i cili bashkë me Stoltenbergun do ta vlerësojnë grumbullimin e trupave ruse në kufi me Ukrainën. "Rusia duhet t'i japë fund këtij grumbullimi ushtarak



në dhe përreth Ukrainës dhe t'i ndalojë provokimet e saj", ka thënë sekretari i përgjithshëm i NATO-s.

## Komisionari i BE-së, letër Kurtit: Dialogu duhet të rinisë shpejt

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Oliver Varhelyi, i ka shkruar letër kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, të cilit i ka kërkuar rinisje të shpejtë të dialogut për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kthimi i perspektivës evropiane të Kosovës në një realitet për

qytetarët e saj gjithashtu kërkon një vazhdim të shpejtë të dialogut Beograd-Prishtinë të lehtësuar nga BE-ja dhe normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Serbinë", thuhet në letrën e Varhelyit. Ai ka thënë se një gjë e tillë është jetike për rrugën e secilit shtet drejt BE-së. "Kjo është thelbësore për rrugën

përkatëse evropiane të Kosovës dhe Serbisë dhe për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal", thuhet tutje.

Komisioneri i BE-së ka thënë se mezi pret që të takohet me kryeministrin Kurti.

Më tej, ai ka thënë se luftimi i pandemisë mbetet prioritet kryesor: "Luftimi i pandemisë së koronavirusit

dhe pasojave të saj socio-ekonomike do të mbetet një prioritet kryesor për të ardhmen e parashikueshme. BE-ja tashmë ka siguruar ndihmë thelbësore dhe do të vazhdojë të qëndrojë pranë Kosovës gjatë kësaj kohe sfiduese", thuhet në letrën e komisionarit për Zgjerim të Bashkimit Evropian, Oliver Varhelyi.



## Presidentja Osmani priti në takim tre paraardhësit e saj



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim tre ish-presidentët e Kosovës, Fatmir Sejdiu, Atifete Jahjaga dhe Behgjet Pacolli. Osmani ka thënë se ky takim ndihmon për të ndërtuar një model të ri të konsultimit të ish-presidentëve, sidomos për çështje të interesit nacional

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar të martën ish-presidentët e Kosovës, Fatmir Sejdiu, Behgjet Pacolli dhe Atifete Jahjaga. Osmani ka thënë se i ka ftuar në takim paraardhësit e saj, për të krijuar një kulturë të re "të memories dhe traditës institucionale", e cila, sipas saj, është e nevojshme që shteti i Kosovës të ecë përpara.

Ajo ka treguar se ky takim u thirr për të ndërtuar një model të ri të konsultimit të vazhdueshëm të ish-presidentëve. "Sidomos për çështje që janë të interesit nacional dhe të mirëqenies së qytetarëve tanë, në mënyrë që të mësojmë nga përvoja e tyre dhe vazhdimisht t'i bashkojmë forcat që t'i zgjidhim problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë", ka deklaruar Osmani. Krahas kësaj, Osmani çmoi edhe rolin e secilit ish-

president për shtetformimin e Kosovës. "Besoj shumë se me secilin do t'i bashkojmë forcat për një të ardhme më të mirë", ka thënë ajo. Të tre ish-presidentët, Jahjaga, Sejdiu dhe Pacolli, shprehën gatishmërinë për ta ofruar kontributin e tyre për presidenten Osmani. Vjosa Osmani u zgjodh presidente e Kosovës më 4 prill 2021. Ajo është presidentja e pestë e Kosovës dhe gruaja e dytë që udhëheq këtë post.

## Pasi nuk përmendi UÇK-në, PSD-ja ia vendos Osmanit flamurin në oborr të Presidencës

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Partia Socialdemokrate (PSD), që udhëhiqet nga Dardan Molliqaj, ka zhvilluar të martën një aksion në oborrin e Presidencës, ku ka vendosur flamurin me logon e UÇK-së. "UÇK është themeli i Republikës, zonja presidente! Institucionet e Kosovës, Presidenca dhe të

gjitha të tjerat nuk kanë kuptim as nuk shpjegohen pa UÇK-në. Pa UÇK-në këto institucione nuk do të ishin tonat. Në fakt, do të ishin ose kuislinge ose autonomiste. Të gjithë ne i dimë rrethanat ndërkombëtare dhe momentet që na sollën deri këtu", kanë thënë drejtues të PSD-së.

Ky aksion i PSD-së vjen pas akuzave që kanë shkuar në drejtim të presidentes Vjosa Osmani, pasi që kjo e fundit, në një shkrim ku fliste për Kosharen, nuk e përmendi UÇK-në. Në oborrin e Presidencës janë të vendosur flamuri i BE-së, i Kosovës dhe ai i Dardanisë.





REPUBLIKA E KOSOVËS BËHET GATI PËR KONTINGJENTIN E DYTË TË VAKSINAVE KUNDËR COVID-19

# Në Kosovë pritet të arrijnë mbi 100 mijë doza të vaksinës Pfizer/BioNTech

Kosova deri në fund të qershorit pritet të furnizohet me mbi 100 mijë vakcina Pfizer/BioNTech kundër koronavirusit nga programi COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ndërsa Qeveria e Kosovës ka miratuar të martën nismën për negocimin e marrëveshjes kornizë së kredisë së datës 14 gusht të vitit 2020 ndërmjet Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për financimin e projektit “Reagim emergjent ndaj Covid-19”

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 PRILL - Mbi 100 000 doza të vaksinës Pfizer/BioNTech kundër koronavirusit pritet të arrijnë në Kosovë deri në fund të qershorit. Lajmi është bërë me dije nga programi COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Programi COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili ka për synim shpërndarjen e vaksinave në vendet në zhvillim, ka njoftuar të hënën se 100 620 dozat në fjalë do të arrijnë gjatë raundit të tretë të shpërndarjes, që përfshin periudhën prill-qershor 2021. Në fund të muajit marsit Kosova

ka siguruar nga COVAX 24 000 doza të vaksinës “AstraZeneca”. Të tilla pritet të sigurojë edhe 76 800 deri në fund të majit. Kurse Qeveria e Kosovës të martën ka miratuar nismën për negocimin e marrëveshjes kornizë së kredisë ndërmjet Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për financimin e projektit “Reagim emergjent ndaj Covid-19”, përmes të cilës do të sigurohen edhe 25 milionë euro për blerje të vaksinave dhe pajisjeve të tjera për menaxhimin e masës anti-Covid, krahas 35 milionë eurove të tjera që tashmë janë të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka

thënë se nga këto 60 milionë euro tashmë 35 milionë janë të negociuara dhe shtesë janë edhe 25 milionë të tjera. “Në vazhdim të këtyre masave sot paraqes para jush nismën për negocimin e marrëveshjes së amendamentimit numër një të marrëveshjes ekzistuese me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës për financimin emergjent ndaj Covid-19. I tërë projekti kap vlerën totale prej 60 milionë eurosh, pra kemi 35 milionë euro tashmë për negocimin të nënshkruara, ratifikuara në Kuvend, dhe po bëhet fjalë për një shtesë prej 25 milionë eurosh të cilat sigurohen me këtë

amandamentim. Kjo do ta sigurojë blerjen e vaksinave sipas marrëveshjeve që negocohen nga MSh dhe përfshinë çfarëdo lloj pajisje mjekësore që ka të bëjë me menaxhimin e pandemisë mes të tjerash. Edhe pse marrëveshja do të negocohet pas aprovimit të kësaj nisme dhe themelimit të ekipit negociator, më lejoni të rikujtoj që kushtet e financimit të kësaj banke janë më të favorshme se kushtet e tregut dhe norma e interesit po ashtu mbetet e subvencionuar nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës deri në 1 milion euro”, ka thënë Murati.

**Mësimdhënësit do të vaksinohen me kontingjentin e dytë të vaksinave**

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka deklaruar se mësimdhënësit do të

vaksinohen me kontingjentin e dytë të vaksinave.

Gjatë takimit me sindikatën e Bashkuar të Arsimit dhe Kulturës (SBASHK), ku është pritur nga kryetari Rrahman Jasharaj me bashkëpunëtorë, ajo ka biseduar për gjendjen aktuale në arsim dhe për procesin mësimor në kushte të pandemisë Covid-19, si dhe për vështirësitë e ndryshme me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit në këtë periudhë. “Në takim u bisedua edhe për mundësinë e vaksinimit të mësimdhënësve, në veçanti atyre që kanë probleme shëndetësore, pas arritjes së kontingjentit të dytë të vaksinave”, është bërë me dije në njoftimin e MASHTI-it.

Ministrja Nagavci ka falënderuar të gjithë anëtarët e SBASHK-ut, mësimdhënësit, dhe stafin tjetër për punën e bërë dhe bashkëpunimin me MASHTI-n dhe institucionet e tjera për organizimin e mësimin në kushte të pandemisë. Ajo ka thënë se kthimi në shkolla është

## Edhe 12 viktima dhe 494 të infektuar me Covid-19

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka regjistruar të martën në Kosovë 12 viktima me Covid-19.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjakovë dy raste (80, 73 vjeç), Obiliq dy raste (73, 49 vjeç), Prishtinë dy raste (75, 74 vjeç), Deçan një rast (82 vjeç), Ferizaj një rast (65 vjeç), Kamenicë një rast (63 vjeç), Mitrovicë një rast (61 vjeç), Prizren një rast (81 vjeç), Shtime një rast (57 vjeç).

Sipas këtij institucioni, në 24 orët e fundit janë regjistruar 494 raste të

infektimit me këtë virus, pas testimit të 3 788 mostrave. "Numri total i rasteve pozitive është 98 835 raste nga 482 413 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 008 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 1 009 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 83 591 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 236", ka njoftuar IKShPK-ja.

Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 98 835 pacientë me këtë virus.

## ShSKUK-ja: Ka shtretër dhe hapësira të mjaftueshme për trajtim të pacientëve me Covid

"Falë punës dhe angazhimit të vazhdueshëm të menaxhmentit dhe përkushtimit nga stafi shëndetësor është arritur të krijohen hapësira të mjaftueshme për trajtim të pacientëve që kanë nevojë për spitalizim në klinikat e Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës", kështu është bërë me dije nëpërmjet një njoftimi për media të lëshuar nga Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK). Në njoftim thuhet se, përveç Klinikës Infektive, janë krijuar hapësira me shtretër edhe në

Klinikën Infektive 2 (Mjekësi Sportive), po ashtu në Klinikën Infektive 3 (Interno), por edhe në Klinikën e Pulmologjisë dhe Mjekimin Intensiv - COVID. "Të gjithë pacientët që kanë nevojë për trajtim spitalor mund të shtrihen për trajtim në QKUK, sepse ka hapësira dhe shtretër të mjaftueshme. Lajmet se kinse nuk ka asnjë vend të lirë në QKUK nuk qëndrojnë. QKUK-ja ka ekipet mjekësore 24 orë që ofrojnë trajtim për pacientët me Covid-19", theksohet në njoftimin e ShSKUK-së.

synim i Ministrisë duke uruar që kjo gjendje të përfundojë sa më shpejt dhe të kthehen të gjithë

nxënësit në shkolla. Gjithashtu, ajo ka kërkuar që krahas mësimin të respektohen

edhe masat kundër pandemisë si dhe të bëhet dezinfektimi i shkollave. Me të arritur vaksinat

e para në fund të muajit mars, Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit në Kosovë. Prioritet

në imunizim aktualisht kanë punonjësit shëndetësorë dhe të moshuarit.

# Qeveria miraton konceptdokumentin për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme



Qeveria e Kosovës ka miratuar të martën një konceptdokument për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme që u tha se i hap rrugë hartimit të një projektligji për këtë çështje. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se Projektligji për konfiskimin e pasurisë do të mundësojë konfiskimin e pasurisë së pajustificuar të personave të dyshuar, edhe nëse ndaj tyre nuk ka aktgjykim të formës së prerë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 PRILL - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e gjashtë me radhë ka miratuar konceptdokumentin për pasurinë e fituar në mënyrë të pajustificueshme që u tha se i hap rrugë hartimit të një projektligji për këtë çështje.

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se Projektligji për konfiskimin e pasurisë do të mundësojë konfiskimin e pasurisë së pajustificuar të personave të dyshuar, edhe nëse ndaj tyre nuk ka aktgjykim të formës së prerë. "Inicimi dhe konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme i bën më efikase institucionet

përkatese për konfiskim të pasurisë sepse nuk kërkohet siç përcaktohet me legjislacionin aktual, që një herë duhet të dënohet personi me aktgjykim dënues e pastaj të fillojë procedura e konfiskimit ndaj tij. Kjo po e zgjat jashtëzakonisht procesin e konfiskimit dhe po e bën të padobishëm sistemin ligjor të

konfiskimit", ka thënë Haxhiu. Po ashtu, ajo ka bërë me dije se do të themelohet edhe një agjenci e pavarur e cila do t'i iniciojë procedurat ndaj personave që dyshohet se kanë përfituar pasuri të pajustificuar apo të paligjshme. Haxhiu më tej ka thënë se ky projektligj do të gjejë zbatim që para shpalljes së pavarësisë dhe, sipas saj, do të mbrojë interesin publik. Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme konsiderohet një ndër shtyllat për luftimin e korrupsionit në Kosovë. Sipas ligjeve aktuale, konfiskimi i pasurisë nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë që

është fituar në mënyrë të kundërligjshme, sipas urdhrorit të formës së prerë nga gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent, kurse sekuestrimi nënkupton marrjen e pasurisë nga organi kompetent deri në vendimin e prerë të gjykatës. Rreth 1.6 milion euro është vlera e asetëve të sekuestruara dhe të konfiskuara në vitin 2020 dhe të cilat janë në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar. Vlera totale e pasurisë së administruar nga kjo agjenci, që nga themelimi i saj një dekadë më parë, është afërsisht 40 milionë euro.

## Kryetari i Rahovecit kërkon nga qeveria t'ua japë dëmshpërblimin bujqve të dëmtuar

**RAHOVEC, 13 PRILL (ER)** - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës dëmshpërblimin për bujqit e dëmtuar dhe rritjen e subvencioneve. "Të nderuar fermerë të komunës sonë, më lejoni t'ju njoftoj se në bazë të gjendjes së krijuar

nga pandemia Covid-19, si dhe dëmeve që ka pësuar bujku rahovecas edhe nga vërshimet dhe përmytjet, dje ju kam drejtuar me dy shkresa konkrete Qeverisë së Kosovës dhe kam kërkuar: Dëmshpërblimin e bujqve të dëmtuar dhe rritjen e vlerës së subvencioneve për

vreshtarët, perimtarët, blegtorët... për të gjithë bujqit dhe fermerët", ka njoftuar Latifi. Ai ka thënë se përkrahja që vjen qoftë nga qeveria apo donatorët, ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe mirëqenien e qytetarëve të Rahovecit.



## Drejtori i Inspeksionit në Gjakovë kërkon nga qeveria që t'u bëhet pagesa shtesë inspektorëve sanitarë

**GJAKOVË, 13 PRILL (ER)** - Drejtori i Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës, Fazli Hoxha, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që t'i bëjë pagesat shtesë për inspektorët sanitarë në këtë komunë, duke iu referuar vendimit që është marrë për shtesat në rrezikshmëri nga Covidi për policinë, inspektorët e AUK-ut, zjarrfikësit, mësimehdhësit etj. Hoxha ka shkruar në rrjetin social "Facebook" se inspektorët sanitarë dhe inspektorët e tjerë të autorizuar në Komunën e Gjakovës tash e një vit janë duke mbikëqyrur zbatimin e masave anti-Covid 19 gjatë



orarit të rregullt, pas orarit, në fundjavave dhe festave pa u ndalur. "Qeveria e Kosovës me vendimin e fundit ka dhënë shtesat për rrezikshmëri nga Covidi për policinë,

inspektorët e AUK-ut, zjarrfikësit, mësimehdhësit, etj., por jo edhe për inspektorët sanitarë në Komunën e Gjakovës. Pra, në këtë rast po bëhet padrejtësi

përderisa shumë sektorë të tjerë janë kompensuar nga buxheti i Kosovës. Në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Punë Inspektuese shpreh shqetësimin lidhur me

mosgatishmërinë e Qeverisë së Kosovës për përfshirjen në këtë pako (për shtesat për rrezikshmëri nga Covid-19) edhe inspektorët sanitarë në Komunën e Gjakovës, të cilët çdo ditë ballafaqohen drejtpërdrejt me mundësinë e infektimit me Covid-19", ka thënë Hoxha.

Ai ka theksuar se inspektorët sanitarë në Komunën e Gjakovës edhe përkundër faktit se nuk janë të përfshirë në pagesën shtesë për rrezikshmëri nga Covid-19, vazhdojnë me përpikëri mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre masave të cilat në thelb kanë mbrojtjen e qytetarëve nga Covid-19.

## Haziri përkujton masakrën e fshatit Llashticë

**GJILAN, 13 PRILL (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lufti Haziri, në 22-vjetorin e masakrës së tmerrshme që përfshoi fshatin Llashticë në vitin 1999, ka thënë se janë gjithmonë të freskëta plagët e tmerrit që kaluan banorët e Karadakut dhe gjithë regjionit. Haziri ka thënë se përmes Llashticës kujtojnë edhe masakrën e Llovçës, Lladovës, Zhegrës dhe të gjithë të rënë e prillit, majit e qershorit dhe të gjithë të rënë në luftën për liri. "Ky është 22-vjetori i prillit të madh, i sakrificës, torturës dhe vrasjeve barbare të masakrimit të shqiptarëve. Këtu u vra e u masakrua fëmija më i vogël në luftën çlirimtare të Kosovës dhe plaka më e vjetër në

moshë. Është masakra më e madhe që Gjilani dhe regjioni kanë përjetuar. Ne do ta kujtojmë masakrën si ngjarja më e frikshme e dhembjes së madhe për të gjithë ne në këtë regjion. Llashtica është Reçaku i Anamoravës!", ka thënë Haziri.

Ai ka theksuar se kjo masakër është një plagë e hapur, pasi ende nuk ka filluar asnjë hetim. "Shpresoj shumë në organet e drejtësisë që një ditë drejtësia të shfaqet edhe në këto vendbanime", ka thënë Haziri.

Forcat paramilitare serbe më 13 prill të vitit 1999 kishin vrarë dhe masakruar 26 civilë shqiptarë në Llashticë të Gjilanit.



## Prizreni, komuna e parë me "Pikë vrojtuese"



Prizren, 13 prill (ER) - Prizreni tanimë do të ketë edhe një ofertë të re turistike, "Pikën vrojtuese" (View Point), nga e cila qytetarët dhe turistët mund t'i shikojnë e t'i shijojnë bukuritë natyrore të më të bukurit vend në Kosovë. Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtoreshën e

Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sevil Kazaz, kanë bërë përrurimin e ofertës turistike "Pikën vrojtuese", të instaluar në afërsi të fshatit Jabllanicë dhe Pouskë.

Në kuadër të këtij projekti është bërë rregullimi i ambientit si dhe vendosja e dylbive, të platformës metalike dhe të xhamit

mbrojtës, vendosja e ulëseve dhe tabelës informues si dhe është bërë rregullimi i vendit për parkim të veturave, duke krijuar një ambient mjaft atraktiv për vizitorë. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se Komuna e Prizrenit do të jetë gjithmonë prijëse për krijimin e destinacioneve të reja turistike.

# Heshtja e autoriteteve të Kosovës për targat jolegale në veri

PRISHTINË, 13 PRILL - Në komunat veriore të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan, vazhdojnë të qarkullojnë automjetet me targa jolegale, me akronimin "KM" (Mitrovica e Kosovës), të cilat qytetarët e këtyre komunave i regjistrojnë në territorin e Serbisë.

Zyrtarët e Policisë së Kosovës thonë që nuk kanë ndonjë urdhër nga instancat politike të vendit për ta ndaluar qarkullimin e automjeteve me targat "KM".

Me marrëveshjen e Brukselit për lëvizjen e lirë, e cila u arrit në korrik të vitit 2011 në dialogun teknik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ishte përcaktuar që të gjithë pronarët e veturave që banojnë në Kosovë duhet të përdorin targat 'KS' (Kosovë) ose 'RKS' (Republika e Kosovës) dhe kështu t'i heqin nga përdorimi targat që për serbët e Kosovës i lëshonte Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë.

Targat e tilla ishin me akronimet "KM" (Mitrovica e Kosovës), "PR" (Prishtinë), "UR" (Ferizaj), "PZ" (Prizren), "GL" (Gjilan). Prishtina zyrtare i konsideronte dhe vazhdon t'i konsiderojë të paligjshme. Këtë e konfirmon për "Radion Evropa e Lirë" ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, cila thekson që kjo marrëveshje ka nisur të zbatohet në dhjetor të vitit 2011.

## Automjetet me targa "KM" regjistrohen në Serbi

Një qytetar serb nga Mitrovica e Veriut, me inicialet G. M., identiteti i të cilit është i njohur për "Rel", ka thënë se automjeti i tij, ashtu sikurse edhe ato të shumicës së qytetarëve në komunat e veriut të Kosovës, bart tabela

me targa "KM". "Targat i kam të Serbisë, me 'KM'. Automjetin e regjistroj në Rashkë. Që nga paslufta është kështu dhe pjesa veriore, mendoj se të gjithë i regjistrojnë në Rashkë", ka theksuar qytetari serb nga Mitrovica e Veriut.

Ai ka shtuar se me këto targa kalon pa ndonjë problem edhe në vendkalimet kufitare Kosovë - Serbi në Bërnjak dhe Jarinjë. "Me këto targa nuk mund të qarkulloj vetëm në pjesën jugore të Kosovës. Por, qarkulloj në të gjithë veriun, në Serbi, në Mal të Zi dhe kështu me radhë. Nuk kam pasur probleme, të paktën jo deri më tash", ka treguar qytetari serb nga Mitrovica e Veriut.

Marrëveshja për heqjen e targave që i lëshonte Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë për serbët e Kosovës është zbatuar në të gjitha komunat në jug të lumit Ibër, por jo edhe në komunat veriore.

Zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Besim Hoti, ka thënë për "Rel" se policia ka arritur që në komunat veriore t'i largojë nga qarkullimi automjetet pa targa fare dhe pa sigurim. Megjithatë, ai thekson se automjetet me targat "KM" vazhdojnë të qarkullojnë në komunat veriore të Kosovës, ndërkaq që regjistrimi i tyre bëhet jashtë territorit të Kosovës. "Është e evidente që kanë qenë pjesë e bisedimeve, më herët, të karakterit politik dhe kjo çështje nuk është në nivelin policor për të diskutuar arsyen se pse këto targa janë ende të pranishme në katër komunat e veriut. Por, kryesisht, kjo në atë kohë ka qenë për lehtësimin e tyre (qytetarëve serbë të komunave veriore) dhe për qarkullim më të lirshëm në territorin e Serbisë. Ndërsa, me të njëjtat targa nuk është lejuar qarkullimi në komunat jugore të Kosovës", theksoi Hoti.



Tahiri: Largimi i targave KM, kompetencë e MPB-së

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, e cila e udhëhiqte palën e Kosovës në kohën kur është arritur marrëveshja për lirinë e lëvizjes, përfshirë edhe heqjen e targave që lëshoheshin nga strukturat e atëhershme paralele serbe në Kosovë, ka thënë se marrëveshja nënkupton zbatimin e saj në tërësinë e territorit të Kosovës. Sipas saj, zbatimi i kësaj marrëveshjeje është dashur të ndodhë tash e rreth dhjetë vjet dhe për këtë moszbatim, ajo e fajëson Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë të gjitha mandateve qeverisëse deri më tash. "Ky ka qenë gjithmonë obligim i Ministrisë së Brendshme e cila ka kompetencë në këtë fushë. Natyrisht që derisa ju përmendni se këto targa ende mund të gjenden në veri apo me to kalohet kufiri, atëherë këtu kemi të bëjmë me dështimin e Ministrisë së Brendshme të Kosovës, por edhe të autoriteteve kufitare të cilat kurrësi nuk duhet të lejojnë mundësinë e një qarkullimi të tillë jolegal", ka theksuar Tahiri.

Ajo shtoi se, pavarësisht vonesës, zbatimi i marrëveshjes për heqjen e targave "KM" mund të ndodhë edhe tash.

## Policia e Kosovës nuk ka urdhër që qartëson çështjen e targave

Por, zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Hoti, thotë se asnjëherë nuk kanë marrë ndonjë urdhëresë nga niveli politik për ndalimin e qarkullimit të automjeteve me targa "KM". "Jo, nuk kemi ne një urdhëresë decidoje që qartëson çështjen e këtyre targave të ish-sistemit federativ, përkatësisht të komunave të cilat i kanë pasur në ish-sistemin federativ të Jugosllavisë", është shprehur Hoti. Përderisa automjetet me targa "KM" mund të hyjnë në territorin e Serbisë, përmes pikave kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, automjetet me targat "RKS" nuk mund ta bëjnë këtë pa i hequr tabelat dhe në vend të tyre t'i vendosin tabelat me mbishkrimin "Prova", të cilat ua imponojnë autoritetet kufitare serbe.

## Për targat "Prova" në Serbi, "fajtoje Kosova"

Edita Tahiri edhe për këtë situatë fajëson autoritetet politike dhe institucionale të Kosovës. Sipas saj, në marrëveshjen e vitit 2011, në Bruksel, është vendosur reciprociteti i plotë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për sa iu përket targave të automjeteve. Megjithatë, sipas saj, Kosova ka dhënë afat prej pesë vjetësh që të qarkullohet me targat "KS". Në shtator të vitit 2016 ishte arritur marrëveshja që targat "KS" të hiqeshin fare dhe automjetet e të dyja vendeve t'i bartnin targat përkatëse gjatë qarkullimit në territorin e njëra-tjetrës.

Tahiri, e cila edhe asokohe ishte kryesuese e palës së Kosovës në dialog me Serbinë, thotë se marrëveshja ishte që automjetet e Kosovës të bartnin targat "RKS", ndërkaq ato të Serbisë të kishin targat me akronimet e shtetit serb. Por, sipas saj, kjo duhej të bëhej duke i mbuluar me etiketa apo letra ngjitëse pjesët relevante të targave, siç janë simbolet dhe akronimet e shteteve përkatëse gjatë qarkullimit në territorin e njëra-tjetrës.

Por, qeveria e ish-kryeministrit Isa Mustafa, në të cilën Tahiri ishte ministere për Dialog, siç shpjegon vetë ajo, e kishte vonuar procesin e nxjerrjes së etiketave.

Në vitin 2017, qeveria e ish-kryeministrit Mustafa u rrëzua. Për më shumë, siç thotë Tahiri, as qeveritë që pasuan, përfshirë edhe të tanishmen, nuk u morën me çështjen e targave. "Fatkeqësisht asnjëra (nga qeveritë). Ndërsa mund t'ju them që në atë kohë, pra kur u arrit marrëveshja, patëm tre muaj për t'i nxjerrë këta 'stickera' (letrat ngjitëse) që të fillojë reciprociteti. Në atë kohë pala serbe, në raundin që e patëm në Bruksel, konfirmoi që është e gatshme. Pra, i kishte bërë gati. Ndërsa ne nuk arritëm dhe siç po flasim edhe sot, pra kanë kaluar mbi katër vjet dhe nuk janë ende duke u zbatuar", theksoi Tahiri.

"Rel" i është drejtuar kabinetit të ministrit të Punëve të Brendshme të Qeverisë së Kosovës, Xhelal Sfeçla, me pyetjet se a janë shqyrtuar dokumentet dhe cilat do të jenë hapat e mëtejshme lidhur me çështjen e targave jolegale "KM", sipas marrëveshjes së Brukselit të vitit 2011, si dhe për zbatimin e reciprocitetit për targat, sipas marrëveshjes së Brukselit të vitit 2016.

Deri në publikimin e këtij teksti kjo ministri nuk ka dhënë asnjë përgjigje.



## Anulohet projekti i TIKA-s për restaurimin e Hamamit të Madh

PRISHTINË, 13 PRILL - Komisioni i Ministrisë së Kulturës për Shqyrtimin e Ankesave ka anuluar projektin e Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) për restaurimin e Hamamit të Madh në Prishtinë. Lajmin e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë", Qerim Ondozi, këshilltar për media i ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrullah Çeku. "Po, ky projekt është pezulluar. Arsyetimin për pezullimin e këtij projekti do ta bëjmë publik shumë shpejt", ka deklaruar Ondozi të martën. Hamami i Madh i Prishtinës pritej që të hynte në një fazë të

restaurimit dhe shndërrimit në muze dhe ishte paraparë që për këtë projekt të investoheshin rreth 1 milion euro. Më shumë se gjysma e projektit ishte planifikuar të financohej nga Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) si dhe punimet ishte paraparë që të kryheshin nga një kompani që do të përzgjidhej nga qeveria turke. Projekti që ishte prezantuar në uebfaqen e Komunës së Prishtinës pati nxitur reagime të shumta për shkak se Hamami të Madh, i cili është objekt i trashëgimisë kulturore, i ishte ndërruar emri në "Fatih

Hamami Muzei". Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM) pati njoftuar më 3 mars të vitit 2021, se ka refuzuar ta trajtojë lëndën për Hamamin e Madh të Prishtinës, pikërisht për shkak të emërimit. Shqetësimet e ngritura për projektin për restaurimin e Hamamit të Madh të Prishtinës kanë shtyrë Inspektoratin për Trashëgimi Kulturorë që të ndërmarrë hapa drejt rishikimit të projektit. Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) pati hedhur poshtë



akuzat e fshehjes së ndonjë financiare për restaurimin e qëllimi prapa ndihmës Hamamit të Madh të Prishtinës.

## Sindikata e Shërbimit Korrektues, me shumë kërkesa për ministren Haxhiu

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 PRILL - Përfaqësuesit sindikalë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, të kryesuar nga kryetari i Sindikatës, Zenun Sadikaj dhe nënkryetari Frashër Raçi dhe të tjerë u pritën në takim nga ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Sipas një njoftimi për media, diskutimi në këtë takim kryesisht kishte të bënte me trajtimin më dinjitoz të punëtorëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke adresuar kërkesat e tyre në raport me pagesat shtesë të




premtuara nga qeveria, ndryshimin dhe përplotësimin e Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe statusin e tyre, Ligjin për pagat, pensionet bazë, pastaj sigurimin shëndetësor,

për pajisje me uniforma të reja dhe për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të përgjithshme të stafit etj. Ministria Haxhiu ka shprehur vullnetin dhe mbështetjen e pakursyer për t'i proceduar më tutje kërkesat e sindikatës së punëtorëve, në mënyrë që të gjithë ata, pa dallim, të kenë kushte më të përshtatshme pune, të trajtohen më me dinjitet dhe ta kenë respektin e merituar dhe mbështetjen institucionale. Ajo ka njoftuar përfaqësuesit e sindikatës që Qeveria e Republikës së Kosovës po angazhohet gjithandaj sektorëve

drejt një progresi të dukshëm sa i përket edhe përplotësimin të kushteve të punës, por edhe shërbimeve të merituar të punëtorëve qoftë në nivel të sigurimeve shëndetësore, pensioneve, përmirësim të pagave, kushteve të punës etj., ndonëse pandemia Covid-19 ka vështirësuar ritmin e realizimit të këtyre qëllimeve, gjithsesi do të punohet pandalshëm në atë drejtim. Përfaqësuesit e Sindikatës kanë shprehur mirënjohjen për pritjen e ministres Haxhiu dhe konsideratën për kërkesat e tyre të shprehura në takim.

## Votat e "Romani Iniciativa", Berisha ankohet në Kushtetuese



PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Kryetari i Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha, ka dorëzuar ankesë në Gjykatën Kushtetuese dhe tek Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me votat e partisë "Romani Iniciativa" në vendbanimet e komunitetit me shumicë serbe në zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit. Berisha pret që Gjykata

Kushtetuese të veprojë në formën më të shpejtë të mundshme pasi, sipas tij, dëmet që i janë shkaktuar komunitetit egjiptian janë të mëdha. "Unë pres dhe besoj fuqishëm në profesionalizmin e Gjykatës Kushtetuese që përfundimisht këtë dukurinë e orkestrimit dhe këtë tendencën me marrë Lista serbe shtetin e Kosovës në 'dorë',

besoj se Gjykata Kushtetuese do ta japë fjalën e fundit", ka thënë ai. Ish-deputeti Berisha që po i konteston votat e deputetit Fadil Gashi nga "Romani Iniciativa" thotë se po e kundërshton vendimin e Gjykatës Supreme dhe të PZAP-së për faktin që ai vendim ka qenë i mangët, i njëanshëm dhe i padrejtë ndaj egjiptianëve.

## Ministri Sveçla vizitoi Qendrën e Mbajtjes në Vranidoll

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka vizituar të martën Qendrën e Mbajtjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku është pritur nga udhëheqësi i kësaj qendre, Selman Nimanaj, i cili e njoftoi ministrin në përgjithësi për


punën dhe aktivitetet me personat që mbahen në Qendrën e Mbajtjes së MPB-së. Me këtë rast ministri Sveçla u njoftua nga afër lidhur me kushtet dhe sfidat me të cilat përballlet kjo qendër si dhe theksoi përkushtimin e tij për krijimin e kushteve sa më të mira të personave që mbahen

në këtë qendër, duke iu garantuar të drejtat e tyre sipas të gjitha konventave ndërkombëtare që e rregullojnë këtë fushë. Në Qendrën e Mbajtjes qëndrojnë persona nga shtete të ndryshme të botës që zihen duke qëndruar në Kosovë pa dokumente.





# Përfundojnë takimet e FMN-së me BB-në, merrte pjesë edhe BQK-ja



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 13 prill** - Përfaqësues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka marrë pjesë në takimet pranverore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, që edhe këtë vit, për shkak të pandemisë Covid-19, u organizuan nga distanca. Në takimet pranverore, të cilat u zhvilluan nga data 5 deri më 12 prill 2021, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti dhe përfaqësuesit e BQK-së morën pjesë në takim

me drejtorin e Departamentit për Evropë të FMN-së, Alfred Kammer, me të cilin u diskutua për zhvillimet e fundit ekonomike, fiskale dhe financiare, si dhe lidhur me planet dhe pritjet për vitin 2021. Për këto zhvillime u diskutua edhe në takimin me ekipin e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti informoi përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar lidhur me gjendjen në sistemin financiar të vendit. Përfaqësuesit e BQK-së

zhvilluan takim edhe përfaqësues të FMN-së, përkatësisht me Departamentin e Politikave Monetare dhe Tregjeve të Kapitalit, ku u diskutua lidhur me procesin e zbatimit të rekomandimeve të dala nga asistentat e mëhershme teknike të FMN-së. Në këtë takim u shpreh edhe interesi për përkrahje në të ardhmen, për fushat me rëndësi për BQK-në. Guvernatori Mehmeti dhe përfaqësuesit e BQK-së morën pjesë edhe në takimin plenar të Komitetit Monetar Financiar

Ndërkombëtar të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku u diskutuan tema të ndryshme që kanë të bëjnë me adresimin e pandemisë, promovimin e rimëkëmbjes së qëndrueshme gjithëpërfshirëse dhe ringjalljen e bashkëpunimit global. Guvernatori Mehmeti mori pjesë në takimet e ndara të Konstituencës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Konstituencës të Bankës Botërore, pjesë e të cilave është edhe Republika e Kosovës, si dhe në takimin e organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar

me temë "Perspektiva dhe sfidat e politikave për Evropën". Takimet pranverore të Bordit të Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Grupit të Bankës Botërore bashkojnë bankierët e bankave qendrore, ministrat e financave, drejtuesit e sektorit privat, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe akademikëve për të diskutuar për çështjet e financave të fokusuar në ekonominë globale, zhvillimin ndërkombëtar dhe ato të sistemit financiar botëror.

## Ministri Murati dhe shefi i BE-së në Kosovë bisedojnë për krijimin e Fondit Sovran

**PRISHTINË, 13 PRILL (ER)** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyog, gjatë një takimi njoftues të martën, kanë biseduar për agjendën zhvillimore të qeverisë, me theks të veçantë për ristrukturimin e skemave sociale, luftimin e informalitetit dhe krijimin e Fondit Sovran. Ministri Murati dhe shefi i BE-së në Kosovë kanë biseduar edhe për masat që do të ndërmerren për luftimin e efekteve negative të pandemisë në ekonominë e vendit dhe për ndihmën që do

t'i ofrohet sektorit privat në këtë drejtim nga qeveria me qëllim të ruajtjes së vendeve të punës dhe shëndetit ekonomik të vendit. Gjatë takimit është theksuar edhe plotësimi i kushteve për disbursim të mbështetjes makro-financiare dhe mbështetjes sektoriale buxhetore të ofruar nga BE-ja për Kosovën. Të dy përfaqësuesit e institucioneve kanë rikonfirmuar angazhimin e përbashkët për implementim të reformave strukturore ekonomike, si dhe për mbështetje drejt zbatimit të projekteve infrastrukturore të përbashkëta, siç është rehabilitimi i termocentralit



"Kosova B". Kurse shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë (BE), Tomas Szunyog, e ka njoftuar ministrin Murati për projektet

e ndryshme të financuara nga BE-ja dhe statusin e tyre. Ai ka vlerësuar faktin se qeveria ka objektiva zhvillimore të ngjashme me ato të Bashkimit

Evropian dhe shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm në fusha të interesit të përbashkët.

## Klubi i Prodhuesve fillon iniciativën e Rrjetit të Etiketave Private

**PRISHTINË, 13 PRILL (ER)** - Klubi i Prodhuesve ka filluar iniciativën e Rrjetit të Etiketave Private (Private Label Network Kosovo), që synon të mbështesë, të zhvillojë dhe të promovojë prodhuesit e etiketave private.


Etiketave Private (Private Label) janë një nga fenomenet më interesante në tregjet e zhvilluara, ku vitet e fundit kanë përjetuar një evolucion të fuqishëm. Pikërisht për këtë fakt, Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka filluar këtë

iniciativë e cila synon që t'i familjarizojë prodhuesit kosovarë me këtë koncept; Të rrisë eksportin e produkteve vendore duke gjetur tregje të reja për prodhuesit; Të zhvillojë trajnime për kompanitë të cilat

angazhohen me private label; Promovimin e kompanive të cilat merren me private label; Të zhvillojë strategji të rritjes së biznesit përmes private labels dhe ta rrisë bashkëpunimin në mes të prodhuesve, shitësve me shumicë/pakicë.

 Private Label Network Kosovo

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
 'BUJQËSIA'  
 TEL: 045/82 82 82**

# Ylli dhe Peja në finale të Ligës Unike

**Prishtinë, 13 prill** - Golden Eagle Ylli ka kaluar në finale të Ligës Unike, duke mundur Goga Basket 74:86 (18:22, 31:19, 16:22, 9:23), në gjysmëfinale të kësaj gare. Çereku i parë ishte i baraspeshuar me të dy skuadrat që herë njëra e herë tjetra kalonin në epërsi, derisa Ylli arrin që të fitojë këtë pjesë 18:22. Edhe perioda e dytë ishte kryesisht e barabartë, ku të dy skuadrat tregonin dëshirën e madhe për të fituar, por në fund skuadra durrësake me një seri të mirë, e përfundon pjesën e parë në të mirë të tyre 49:41. Ylli u rikthye në periodën e tretë, duke treguar një lojë të mirë dhe dy minuta nga fundi, barazon shifrat në 60:60, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 65:63. Kjo bëri që 10 minutat e fundit të ishin shumë interesant dhe vendimtar. Ylli shkëlqen në periudhën e fundit, ku arrin epërsinë më të lartë 69:82. Goga



tenton të rikthehet në fund, por nuk ia arrin qëllimit dhe skuadra nga Theranda fiton 74:86. Te Goga Basket u dalluan Milic Blagojeviq me 26 pikë e 8 kërcime dhe Endrit

Hysenagolli me 11 pikë e 14 kërcime, kurse te Golden Eagle Ylli u dalluan Elayja Clark me 18 pikë e 6 kërcime, Gëzim Morina me 12 pikë e 11 kërcime, Lg Gill me 15

pikë dhe Valon Bunjaku me 13 pikë. Ylli në finale do të përballet me Pejën, kurse Rahoveci do të ndeshet me Goga Basket për vendin e tretë. Në një ndeshje dramatike, Peja ka shënuar fitore ndaj Rahovecit 71:73 (17:15, 16:20, 13:30, 25:8), në gjysmëfinale të Ligës Unike. Ndeshja në fakt nisi e baraspeshuar dhe në çerekun e parë asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej, derisa kjo pjesë përfundon 17:15. Luftë për çdo top u zhvillua edhe në periudhën e dytë, ku pejanët ishin për një nuancë më të mirë, duke e fituar këtë pjesë 16:20, duke shkuar në pushim me shifrat 33:35. Në periodën e tretë, verdhezinjtë dominuan totalisht, si në sulm, ashtu edhe në mbrojtje. Me kalimin e minutave pejanët thelluan epërsinë, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 46:65. Por, Rahoveci nuk u dorëzua, duke u rikthyer

fuqishëm. Vreshtarët ngushtuan shifrat në 63:67, vetëm 3 minuta nga fundi, me një seri të suksesshme prej 17:2. Deri në fund u zhvillua ndeshje dramatike, ku 10 sekonda nga fundi pranë rezultatit 71:73, Rahoveci kishte aksionin e fundit, por një super bllokadë nga Lis Shoshi dhe huqja e Darell Davis, bëri që Peja të kalojë në finale, ku e pret fituesin e ndeshjes Goga Basket-Golden Eagle Ylli. Te Rahoveci u dallua Darell Davis me 35 pikë, kurse te Peja u dalluan Brandon Walters me 20 pikë e 11 kërcime, Lis Shoshi me 18 pikë e 10 kërcime dhe Aj Walton me 18 pikë e 8 kërcime. Të mërkurën (sot) do të zhvillohen ndeshjet për vendin e tretë dhe finalja e madhe.

**14 Prill**  
**16:00 Ndeshja për vendin e tretë**  
**19:00 Finalja e madhe**

# Liverpooli beson në përmbysje kundër Realit



**Liverpool, 13 prill** - Liverpooli e humbi ndeshjen e parë kundër Real Madridit në Spanjë (3-1) dhe tash synon që ta përmbysë rezultatin dhe të kualifikohet në Gjysmfinale. Trajneri Jurgen Klopp ka thënë se "Reds" nuk ka çfarë të humbasë dhe do të provojë të gjitha mundësitë. "Ne tashmë e dimë që nuk është një sezon i shkëlqyeshëm. Me një rezultat 3-1 duket se tashmë jemi jashtë Ligës së Kampionëve

**Të mërkurën takohen:**  
**Liverpool - Real Madrid (1-3)**  
**Borussia Dortmund - Manchester City (1-2)**

dhe se nuk kemi asgjë për të humbur, por do të provojmë. Kundërshtari në ndeshjen e parë ishte më i mirë se ne, por ishte vetëm gjysma e punës. Tash duhet të jemi në një nivel të lartë për të pasur ndonjë shans të kualifikimit", ka thënë Klopp. Të dyja klubet realizuan fitore në ndeshjet e fundjavës. Liverpooli e mposhti Aston Villën, kurse Realit triumfoi kundër Barcelonës në "El Clasico". Në anën tjetër Realit është duke kaluar nëpër një formë fantastike dhe do të mundohet të mos lejojë befasi dhe ta sigurojë kualifikimin për fazën

tjetër. "Reds" edhe në këtë ndeshje do të jenë pa mbrojtësit Joe Gomez, Virgil van Dijk dhe Joel Matip si dhe pa mesfushorin Jordan Henderson. Në anën tjetër, edhe Realit ka mungesa në këtë ndeshje: Ramos, Varane, Carvajal dhe Lucas Vazquez. Sonte nga ora 21:00 Borussia Dortmund e pret Manchester Cityn. Në ndeshjen e parë City fitoi me rezultat 2-1, por gjermanët nuk do të dorëzohen dhe do të kërkojnë që ta mposhtë skuadrën angleze dhe të kualifikohen në fazën gjysmëfinale që do të ishte një sukses mjaft i madh.

# PSG-ja dhe Chelsea kualifikohen në gjysmëfinale

**Paris, 13 prill** - PSG-ja dhe Chelsea janë dy skuadrat e para që sigurojnë një vend për në gjysmëfinalen e këtij edicioni në Ligën e Kampionëve. Skuadra parisienë ju falë fitores 3-2 në Gjermani, pasi mbrëmjen e sotme pësoi një humbje minimale 0-1, por për shkak të golave në fusë kundërshtare kualifikohen ata. Ishte një duel që do të sillte raste të shumta në

gjysmë-orëshin e parë, me Neymar që gjeti traversën dhe shtyllën, por fati nuk ishte me të. Në krahun tjetër Bayerni do të gjente golin. Në minutën e 40-të, pas një aksioni të gjatë, Navas ndal Alaban, por më pas e kishte të pamundur për të ndalur Choupo-Mouting. Sulmuesi është shumë i saktë në goditjen me kokë. Në fraksionin e dytë Bayerni tentoi me të gjitha mënyrat

për të shënuar, por Navas i ndali mjaft mirë, ndërkohë që u ndje mungesa e Lewandowskit. Në krahun tjetër Neymar shpërdoroi sërish dy mundësi të tjera. PSG rezistoi deri në fund duke siguruar kualifikimin. Chelsea u mund 0-1 në sfidën e kthimit, por kaloi në fazën tjetër pas suksesit 2-0 në Portugali. Taremi shënoi golin e vetëm mbrëmjen e sotme në minutën e katërt të shtesës.



## Pesë vjet pa ftesë nga Zvicra, Shqipëria tenton Kasamin

TIRANË, 13 PRILL - Pajtim Kasami mund ta përfaqësojë Kombëtaren e Shqipërisë. "Panorama Sport" ka mësuar ekskluzivisht se ideja më e fundit në qarqet sportive pranë ekipeve kombëtare, po diskutohet çështja "Pajtim Kasami". Gazeta ka mësuar se njerëz të rëndësishëm pranë FSHF-së dhe ekipeve kombëtare kanë bërë një punë

të dyfishtë: Së pari t'ia komunikojnë trajnerit Reja nëse e pranon si alternativë për të ardhmen. Së dyti, ta kontaktojnë vetë mesfushorin. Por, çështja nuk është kaq e bardhezi. Kasami është një futbollist që ka luajtur me kombëtaren helvete të Zvicrës. Në 12 ndeshje prej tyre ka qenë në stol edhe kundër Shqipërisë në vitin 2013. Kjo në thelb

përbën një nga pengesat thelbësore për Kasamin si kuqez, mirëpo me ndryshimet e fundit të bëra në Rregulloren e FIFA-s, ka edhe disa klauzola juridike që mund të përdoren për ta marrë lejen në FIFA. Kasami nuk ka luajtur me Zvicrën as në fazën finale të Evropianit dhe as në atë të Botërorit. Një pikë domethënëse që nëse ka

ndodhur, ia ndalon një futbollisti ta ndryshojë kombëtaren. Këto janë pika ligjore në rregulloret e FIFA-s, që ia lejojnë Kasamit dhe Shqipërisë të mund të bëjnë kërkesë në FIFA që mesfushori i lindur në Zvicër dhe me origjinë të familjes Strugën, të mund të provojnë betejën ligjore që në të ardhmen, Kasami të jetë një lojtar i



gatshëm për kombëtaren shqiptare.

## Sot dhe nesër ndeshjet e xhiros së fundit në hendboll

PRISHTINË, 13 PRILL - Të mërkurën e të enjten luhen ndeshjet e javës së 28-të të Superligës A të Kosovës në hendboll. Është kjo java e fundit e stinorit të rregullt në kampionatin e hendbollistëve. Më pas titulli i kampionit përcaktohet përmes plejofit. Të mërkurën prej orës 17:30 është takimi Vëllaznimi - Trepça. Vëllaznimi kërkon fitore për t'i barazuar pikët me Kastriotin dhe për të shpresuar që të paraqitet në plejof. Aktualisht Kastrioti është i katërti me 26 pikë, ndërsa Vëllaznimi i pesti me 24 pikë. Nëse Vëllaznimi fiton ndaj Trepçës dhe Kastrioti humb ndeshjen e fundit, atëherë skuadra gjakovare përfundon e katërta. Trepça është e treta me 28 pikë dhe në këtë pozitë do ta përfundojë kampionatin. Të enjten janë dy ndeshjet e tjera. Prej orës 17:30 takohen Besa Famgas e Drenica.



Skuadra pejana, Besa Famgas, nuk pritet të ketë telashe. Kështu kampionia aktuale pritet ta përfundojë edhe një edicion të rregullt me vetëm fitore. Besa Famgas ka fituar 27 ndeshjet e deritashme dhe udhëheq në tabelë me 54 pikë. Drenica është e gjashta me 16 pikë. Prej orës 19:00, të

enjten, takohen Prishtina e Kastrioti. Prishtina është e dyta me 43 pikë dhe prej kësaj pozite do të nisë në plejof. Me fitore eventuale të Vëllaznimit ndaj Trepçës, ndeshja në kryeqytet do të ishte shumë e rëndësishme për Kastriotin, që do t'i duheshin pikë për ta mbajtur vendin e katërt.

## Curry parakalon legjendën Chamberlain, bien lakersat

SAN FRANCISCO, 13 PRILL - Mbrëmje fantastike për Stephen Curryn, "yllin" e Golden State Warriorsit që rrëmbeu skenën e "Chase Center" të San Franciscos në suksesin 116-107 të skuadrës së tij përballë Denver Nuggetsit. Plot 53 pikë realizoi Curry, duke qenë i saktë në 10 nga 18 gjuajtjet për tre, që përbën dhe paraqitjen e tij të katërt më të mirë në karrierë, por më i rëndësishëm është fakti që parakalon një legjendë të Warriorsit, Wilt Chamberlain, për numrin total të pikëve të shënuara për skuadrën kaliforniane. Curry ka arritur kuotën e 17 818 pikëve, ndërsa i madhi Chamberlain i 100 pikëve në një ndeshje është ndalur në shifrën 17 783, raporton "SS". Për Denverin bëri gjithçka munda Nikola Jokiq, autor i 27 pikëve dhe 12 "reboudeve", ndërsa lajmi më i keq është dëmtimi i Jamal Murrayt në gjurin e majtë, pas një rënieje të pakontrolluar në fund të takimit. Kryesuesit e Konferencës së Perëndimit, Utah Jazz, u



mposhtën në parketin e Washington Wizardsit 121-125. Pavarësisht prej 42 pikëve të Donovan Mitchellit dhe 33 të Bogdan Bogdanoviçit, Jazz u dorëzua përballë Bradley Beal, autor i 34 pikëve, dhe Russell Westbrook, që e mbylli takimin me "triple-double": 25 pikë, 14 "reboude" dhe 14 asistime. Nuk e ndalin marshimin Phoenix Suns, që iu imponua 126-120 Houston Rocketsit me 26 pikë të shënuara nga Jae Crowder dhe 24 Devin Booker. Fitoi edhe Philadelphia 76ers në parketin e Dallas

Mavericksit me rezultatin 95-113. Ndal hapin skuadra teksane, së cilës nuk i mjaftuan 32 pikët e sllonit të famshëm Luka Doniq, teksa për 76ers spikati me plot 36 pikë Joel Embiid. Një tjetër emër i madh i Konferencës së Perëndimit pëson humbje. Bëhet fjalë për Los Angeles Lakers, që pa shërbimet e LeBron Jamesit dhe Anthony Davisit u dorëzuan 111-96 në "Madison Square Garden" përballë New York Knicks, në radhët e të cilëve spikati me 34 pikë dhe 10 "reboude" Julius Randle.

### REZULTATET

New York Knicks - Los Angeles Lakers	111-96
Dallas Mavericks - Philadelphia 76ers	95-113
Orlando Magic - San Antonio Spurs	97-120
Memphis Grizzlies - Chicago Bulls	101-90
New Orleans Pelicans - Sacramento Kings	117-110
Utah Jazz - Washington Wizards	121-125
Golden State Warriors - Denver Nuggets	116-107
Phoenix Suns - Houston Rockets	126-120
Minnesota Timberwolves - Brooklyn Nets (e shtyrë)	

### SHKURT

#### Perezi rizgjidhet president i Realit

Florentino Perez është rizgjedhur president i Real Madridit. I pari i klubit spanjoll nuk kishte asnjë kundërkandidat dhe me vota unanime është rizgjedhur kryetar i klubit. Perez do të jetë në krye të klubit mbretëror deri në vitin 2025. Lajmi është konfirmuar edhe nga faqja zyrtare e skuadrës spanjolle. "Florentino Perez është rizgjedhur president i klubit deri në vitin 2025", thuhet në njoftimin e madrilenëve. Për Perezin ky do të jetë mandati i gjashtë si president i Real Madridit. Perez e ka udhëhequr ekipin spanjoll që nga viti 2000. Nën udhëheqjen e Perezit, Real Madridi ka fituar 47 trofe.

#### Një ndeshje moslojë dhe 5 000 euro dënim për Ibrën

Vetëm një javë shkualifikim për Zlatan Ibrahimoviçin. Sulmuesi i Milanit duhet të paguajë edhe një gjobë prej 5 000 eurosh pas ndëshkimit me karton të kuq nga arbitri Maresca në minutën e 60 kundër Parmës. "Bëri një veprim provokues, kritika dhe mosrespekt ndaj gjyqtarit të ndeshjes", shkruhet në motivacionin e Gjykatës Sportive për dënimin e suedezit. Në këtë mënyrë kuqezinjtë humbasin shërbimet e Ibrahimoviçit për duelin ndaj Genoas që do të luhet të dielën në orën 12:30.

#### Nëse largohet Mbappe, PSG-ja transferon Sanchon

Kýlian Mbappe dëshiron të provojë një përvojë të re dhe prej kohës në media është raportuar se sulmuesi u ka kërkuar drejtuesve të PSG-së ta shesin atë. Gjithsesi ata po përpiqen ta bindin të rinovojë. Nëse kampioni i botës nuk do të jetë dakord me propozimin e klubit, te PSG-ja po mendojnë edhe për një plan B. Mbappe, sipas asaj që shkruan "The Athletic", ka piketuar pasuesin e sulmuesi dhe ai është një yll i Bundesligës. Nuk është Erling Haaland, por Jadon Sancho i cili ka kontratë me Borussia Dortmundin deri në qershor të vitit 2023.

#### Juve-Ronaldo, e ardhmja vendoset në fund të sezonit

Në skuadrën e Juventusit kanë filluar të punojnë për sezonin e ri dhe çështja e parë që kërkon zgjidhje është ajo e Cristiano Ronaldos. Portugezi dukshëm nuk është i lumtur, këtë e shfaq thaujse në çdo rast kur nuk arrin të shënojë. Ronaldo ka një kontratë deri në vitin 2022, nuk diskutohet për rinovim pasi për momentin as prania e tij sezonin e ardhshëm nuk është e sigurt, pasi Ronaldo ka nevojë për Ligën e Kampionëve, nëse nuk arrihet ky objektivi vështirë të mendohet se portugezi do të qëndrojë. Jo vetëm Ronaldo, Paratici duhet të mendojë edhe për Dybala e Morata.

## Ramosi infektohet me Covid

Kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, është infektuar me Covid-19. Përveç tij, ditë më parë u infektua edhe bashkëlojtari i tij në mbrojtje,

Raphael Varane. "Real Madridi njofton se lojtari Sergio Ramos ka dalë pozitiv në testin për Covid-19", ka shkruar Real Madridi në

uebsajtin e vet zyrtar. Ramos nuk ka qenë shumë në kontakt fizik me bashkëlojtarët, sepse nuk është stërvitur në javën e

fundit duke qenë se është duke u riaftësuar nga lëndimi i muskullit. Varane është duke u shëruar nga virusi momentalisht. Ndërsa

Mariano, Eden Hazard, Eder Militao, Casemiro, Stefan Joviq dhe Nacho bashkë me trajnerin Zinedine Zidane e kanë kaluar virusin tashmë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ EX-FIS” Sh.p.k , Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve ne Piranë, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.05.2021 në ora 11:30 në Retoran “ OK“ në Korishë i cili ndodhet ne anën e majtë të Magjistrales Suharekë- Prizren do të organizohet debat publik nga Kompania “ EX-FIS” Sh.p.k , Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve ne Piranë, Prizren

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:  
<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJCUt09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ EX-FIS” Sh.p.k , Prishtinë për stacionin e karburanteve ne Piranë, Prizren.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “ EX-FIS” Sh.p.k , Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve ne Korishë, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.05.2021 në ora 10:00 në Retoran “ OK“ në Korishë i cili ndodhet ne anën e majtë të Magjistrales Suharekë- Prizren do të organizohet debat publik nga Kompania “ EX-FIS” Sh.p.k , Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve ne Korishë, Prizren

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:  
<https://us04web.zoom.us/j/7491688086?pwd=U05XRGMzcHpHRjI1OHhxdmNpUWJCUt09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ EX-FIS” Sh.p.k , Prishtinë për stacionin e karburanteve ne Korishë, Prizren.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Forever Living Products Hungary LTD Budapest”-Dega në Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NB: 810483488, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Forever Living Products Hungary LTD Budapest” filijala na Kosovu, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom BB: 810483488 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Forever Living Products Hungary LTD Budapest”, Branch in Kosovo, has taken the decision to quit its business with NB: 810483488, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

“Epoka e re”

Prishtinë, 12.04.2021



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.  
 Prishtinë – Kosovë  
 Luan Haradinaj, p.n.  
 e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
[www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com)  
 Nr. 11/333 Dt 12.04.2021

Në bazë të nenit 53, paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, nr. 05/L-031 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Menaxhmenti i NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më datën 06.04.2021, bie këtë:

### VENDIM

Për anulim të konkursit

**I. ANULOHET**, konkursi i publikuar në gazetën e përditshme informative “Epoka e re” më datën 16.03.2021, për plovësimin e vendit të punës, punëtor fizik – pastroes i mirëmbajtjes higjienike në njësinë e ndërtimit dhe mirëmbajtjes higjienike në Departamentin teknik – higjienik (4 punëtorë), për shkak se procedurat e konkursit nuk janë ndjekur në tërësi, nga situata e krijuar pandemike dhe mos ngarkesa financiare, përkundër nevojës për punëtorë fizik – pastroes.

**II.** Konkursi i ri do të shpallet, pas krijimit të kushteve më të përshtatshme financiare.

**III.** Obligohen të gjithë kandidatët, brenda muajit prill 2021, të tërheqin dokumentacionet e dorëzuara në arkivën e NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

Ti dorëzohet:  
 1x Gazetat e përditshme informative,  
 1x Tabela e shpalljeve,  
 1x Dep. Adm. Qendror,  
 1x Arkivës.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Gold Tobacco" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fabrikën për prodhimin e nargjilës në Prizren

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.05.2021 në ora 10:00 në hapësirat e Restorantit "Healthy food", rruga De Rada p.n. Prizren do të organizohet debat publik nga Kompania "Gold Tobacco" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fabrikën për prodhimin e nargjilës në Prizren.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:

<https://us05web.zoom.us/j/7944094180?pwd=ZmFzaERoSHQ5anh0L1JlNUZndis5Zz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Gold Tobacco" Sh.p.k Prizren për Fabrikën për prodhimin e nargjilës në Prizren.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)  
Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Shpejtim Karce shpall te pavlefshëm diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Franc Pergjoka shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Seit Sabani shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Prallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

\*\*\*

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



**DEKALOGU**  
nga Moisiu deri te Kieślowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLOWSKI

AGRON SHALA



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# PASHTETË PULË

gluten free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues